



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE
KORÇË

Nr 24/2 Prot.

Korçë, më 18.03.2026

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 16 datë 18/03/2026

MBI MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË PLANIT TË
INTEGRITETIT PËR QTTB KORÇË 2025

Në mbështetje të VKM Nr.515, datë 19.07.2006 “Për ristrukturimin e instituteve kërkimore-shkencore, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit” i ndryshuar, Rregullores së brendshme të QTTB Korçë, Planit të Integritetit të QTTB Korçë, si dhe shkresës me Nr 891/1prot, datë 04/02/2026, ardhur nga MBZHR:

URDHEROJ

1. Miratimin e Raportit të Monitorimit për zbatimin e Planit të Integritetit për QTTB Korçë, për vitin 2025, të përgatitur nga grupi i punës ,në përputhje me kërkesat e parashtruara në Urdhërin e brendshëm .
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

TITULLARI I KOMANDUAR

Emiljano Muhareem





QENDRA E TRANSFERIMIT
TË TEKNOLOGJIVE
BUJQËSORE, KORÇË

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE, KORÇË

RAPORT MONITORIMI
ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT
TË QENDRËS SË TRANSFERIMIT TË
TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE

2025

RAPORT MONITORIMI

ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE KORÇË 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje ekzekutive
Qasja vlerësuese.....
Masat dhe aktivitetet e parashikuara për zbatim për vitin 2025 dhe niveli i realizimit për secilin objektiv.....
Përfundime.....

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport përmban një analizë të detajuar të progresit të bërë gjatë vitit të parë të zbatimit të Planit të Integritetit të QTTB Korçë për periudhën Janar – Dhjetor 2025. Monitorimi është kryer nga Njësia e Monitorimit të Integritetit dhe synon të vlerësojë masat e ndërmarra për:

- Përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies
- Forcimin e masave kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesit
- Rritjen e cilësisë së shërbimeve për fermerët
- Monitorimin dhe vlerësimin e përmirësimeve të institucionit

Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqesore Korce në ndërgjegjësim të sfidave dhe qasjeve kundër korrupsionit ka hartuar Planin e Integritetit **në QTTB, në zbatim të Urdhrit Nr. 20, datë 27.05.2025.**

Integriteti është me rëndësi të jashtëzakonshme për krijimin e institucioneve publike transparente dhe të përgjegjshme dhe ndihmon që qytetarët të binden se ata punojnë për interesin e tyre.

Korrupsioni, konflikti i interesit, mungesa e etikës, janë fenomene që favorizojnë përjashtimin, pabarazinë dhe mos besimin në institucionet publike. Lufta kundrejt këtyre fenomeneve dhe mbi të gjitha parandalimi i tyre, është përgjegjësi institucionale e QTTB Korçë, e çdo punonjësi dhe drejtuesi të saj, në ushtrimin e veprimtarisë së monitorimit dhe mbikëqyrjes së të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave. Në këtë kontekst planet e integritetit jo vetëm forcojnë institucionin për të parandaluar korrupsionin, por njëherazi kontribuojnë në përfitim të një culture të menaxhimit publik me etikë dhe integritet.

Plani i Integritetit 2025, i miratuar synon përmirësime dhe përditësime në fushat dhe drejtimet e veprimtarisë së QTTB Korçë, si:

Objektivi I: Menaxhimi i burime njerëzore (Hartimi i proceseve të punës, Plotësimi i vendeve vakante dhe Trajnimi i vazhdueshëm i stafit)

Objektivi II: Zhvillimi i Sektorit Bujqësor dhe Blegtoral (rritja e prodhimit/prodhimtarisë së bimëve dhe kafshëve)

Së fundi QTTB Korçë është e vetëdijshme se Plani i Integritetit 2025, si i pari që institucioni miraton, do të pasohet nga plane të tjera, duke krijuar përvojën e duhur në procesin e hartimit dhe zbatimit të tyre duke i bërë këto dokumente të përhershme institucionale. Ruajtja e integritetit institucional është një proces i vazhdueshëm dhe i monitorueshëm dhe kjo po realizohet nëpërmjet raportit të monitorimit të këtij plani.

Qasja vlerësuese

Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të QTTB Korçë, përmban një analizë të përgjithshme të kuadrit rregullator mb aspektet e integritetit, performances institucionale (për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit) si dhe çështje të transparences në luftën kundër korrupsionit. Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të 2 drejtorive dhe të një grupi të brendshëm pune.

Plani i integritetit i QTTB Korçë është një dokument që paraqet standard profesionale, duke parashikuar objektiva madhore dhe masat që duhen të zbatohen nga punonjësit e institucionit për të realizuar dhe përmbushur këtë dokument. Raporti i monitorimit të këtij dokumenti shërben si një mjet për të menaxhuar dhe vlerësuar riskun e integritetit. Nëpërmjet urdhrin nr.prot.70/2, datë 21.06.2023, i pandryshuar për vitin 2025 të ngritur nga Titullari i QTTB Korçe i cili caktoi grupin e punës për Hartimin e Planit të Integritetit.

Masat dhe aktivitetet e parashikuara për zbatim për vitin 2024 dhe niveli i realizimit për secilin objektiv:

Në kontekstin e sektorit publik, integriteti konsiston në përmbushjen e detyrimeve të: transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe efijencës në përmbushjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrative. Vendosja e planit të integritetit dhe sigurimi i zbatimit të tij përbën një qasje që garanton masat antikorrupsion dhe një mundësi të shtuar të suksesit të zbatimit të tyre.

Për zbatimin e planit të integritetit për vitet 2024 janë përcaktuar 2 objektiva të cilat janë të ndara në 5 risqe. Nga monitorimi rezulton se në totalin prej 5 risqeve të evidentuara në Planin e Integritetit 2025, për periudhën raportuese, janë marrë masa për realizimin plotësisht të 4 prej tyre, ndërsa 1 masë është ende në proces.

Objektivi I: Menaxhimi i burimeve njerëzore

- Hartimi i proceseve të punës
- Plotësimi i vendeve vakante
- Trajnimi i vazhdueshëm i stafit

Grupi i punës i ka kushtuar vëmendje të veçantë menaxhimit të burimeve njerëzore dhe forcimit të etikës së integritetit të punonjësve të institucionit.

Ky objektivi përmban një numër prej 3 masash të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen specifikisht proceseve të punës, kërkesës së përhershmenë DAP për plotësimin e vendeve vakante, organizimin e trajnimeve të ndryshme me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike dhe Institucione të tjera si pas fushave të veprimtarisë, përfshirja e grupit të punës për njoftimin në rregulloren e brendshme të institucionit etj.

Për periudhën raportuese lidhur me masat e parashikuara për zbatim me qëllim përmbushjen e Objektivit 1, Grupi i punës ka pasur këtë progres:

- Risku dhe ngjarjet e mundshme: “Gabime të mundshme në realizimin e detyrave ditore duke mos patur një mjet të strukturuar të punëve që duhen realizuar.

Objektivi II: Zhvillimi i sektorit Bujqësor dhe Blegtoral

- Rritja e prodhimit/prodhimtarisë së bimëve dhe kafshëve
- Ofrimi i paketave dhe kartave teknologjike
- Veprimtari prodhuese dhe veprimtari të transferimit të teknologjive

Një ndër qëllimet kryesore të QTTB Korçë është dhe objektivi i II i cili duhet të ndikojë në rritjen e prodhimit, mbrojtjen e mjedisit dhe prodhimit nga mbetjet nëpërmjet futjes së teknologjive dhe praktikave bashkëkohore, futjen e varieteteve dhe racave të reja.

-Risku dhe ngjarjet e mundshme :

-Strukturë e paplotësuar me specialist të fushës

- Mungesë në logjistike (makineri dhe aggregate)

Pas një analize gjithpërfshirëse të sa më sipër, vlerësohet e nevojshme marrja e masave për hartimin e proceseve të punës dhe shpërndarja tek të gjithë punonjësit, hartimi i një plani të mirë konceptuar në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë si dhe kërkesë e përhershme në DAP për plotësimin e vendeve vakante.

II. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Për të siguruar një analizë të hollësishme dhe objektive, janë përdorur metodat e mëposhtme:

1. Auditimet e brendshme – Verifikimi i dokumentacionit mbi financat, vendimmarrjet dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.

2. Intervistat me stafin – Janë zhvilluar intervista me punonjësit për të vlerësuar zbatimin e masave të integritetit.

3. Analiza e dokumenteve – Përfshirë raportet financiare, procesverbalet e mbledhjeve dhe deklaratat mbi konfliktin e interesit.

III. PËRFUNDIME

Plani i Integritetit i QTTB Korçë për vitin 2025 përmban masa të qarta dhe të strukturuar për të garantuar transparencë, llogaridhënie dhe shërbime cilësore për fermerët. Zbatimi i suksesshëm i tij do të kërkojë angazhim të vazhdueshëm nga stafi dhe monitorim të rreptë nga drejtuesit.